

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE



## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2012

### I DETYRUAR

### VARIANTI A

E shtunë, 2 qershor 2012

Ora 10.00

**Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe**

**Gjimnazi: Drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm  
(kurrikula e vjetër)**

**Udhëzime për nxënësin**

Testi në total ka **25 pyetje**, 13 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe 12 pyetje me zhvillim.

Testi është i ndarë në dy pjesë.

Në të tri pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

**Për përdorim nga komisioni i vlerësimit**

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9a	9b	10
Pikët											
Kërkesa	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20a	20b
Pikët											
Kërkesa	21a	21b	22	23a	23b	24	25a	25b	25c	25d	
Pikët											

Totali i pikëve

**KOMISIONI I VLERËSIMIT**

1.....Anëtar

2.....Anëtar

**PJESA I****Ernest Koliqi                      Tregtarë flamujsh (fragment)**

Në raftat deri në tavan që rrethojshin katër zdatkat e odës, tue lanë lirshëm vetëm katrorin e dritores kah oborri mbas dugajës, rrijshin pilue qinda paketash të trasha mbështjellë në letër zverdhurke. Letra e shkyeme vende vende lëshonte pre do paketash skjepin e ndonji kindi të kuq. Disa gypa të gjatë qepë në beze shifeshin të mbështetun pingul për rafta. Hjedhun në një kand afër dritorje venitej të kuqtë e një flamuri me shtizë veshë në kadife. Përmbante mija flamujsh ajo odë e errtë. Vjerrshatari i ri, mësue qyshë prej rinisë ma të parë me shndrue ndjesitë e pacaktueme në parafytyrime të gjalla, mendoi: "Mija agimesh epopeje të kuqe fjetë në burgun e një kohe të mugët".

Humbi në një fluturim të vrikshëm lyrike. I pau ata flamuj të shtjelluam në një dritë të gjalle fitoresh kumbore, në krye të një kombi të lirë mbi udhë plot brohorina t'ardhëmenisë kur era e larit tymonte e pastër drejt qiellit. I pau ato shqipe të zeza tue lirue nga burgu i errët i një kohë te zezueme e tue rrahë flatrat nëpër ajri të kuqe si ëngjaj drejtësie kah skajet ma të fshefuna të maleve e të fushave t'atdheut.

- A shef si kam ra mbrendë? Tue mbajtë uzdajë se nuk do të rrinte shtëpi pa e marrë ka një, i porosita me turra. Por s'blen kurrkush. Me kanë mbetë pa u shitë. Mjaft, pra, ia kam ulë çmimet.

Zani me tinguj metalikë theu shortin e vegimit të largët ajruer. Një zemërim i hovshëm iu gjinikue djaloshit përmbrenda. Kërkoj me mend një të shame që t'i përshtatet.

- Gjynah me mbetë pa u shitë ky farë malli!

Ndërsa me dorën e rrëmakët mbante shtizën, rroku me atë të djathtënjë kind të pëlhurës së kuqe e ju afrue djaloshit tue e ndukë.

- Shih sa cohë e mirë!

Po të vronte dy duer të ndyta tërbue n'epsh shtazarak tue u shtri kah trupi i një krijatyre të njomë e të dashur, përqethje ma e rreptë s'ia kish tronditë mishin e shtatit. Befas e me rrëmbim vërvitës vërviti duert përpara e ia hoq pëlhurën tregtarit. Ky zgërdhuci syt.

Hilush Vilza tha me za t'ultë, por të ndezun:

- Mos e prek me ato duer .

Me za që i dridhej prej pezmit, tjetri ia kthei:

- Po, zati ti s'din veç me qitë bejta. Jeto me prralla, bieru mbas andrrave. Me vjen keq për gjind të tuej se tash i qet në rrugë të madhe, me shka shof un. Hajt, hajt, qit bejta e dueje Shqipnin: bejta e Shqipnija kan me të qitë në dritë...

U afrue edhe ma tepër e pëshpëriti si në një fishkullimë:

- U shitne a s'u shitne flamujt, qëndroi a s'qëndroi Shqipnija, un kam mjaft, shyqyr, me jetue: a more vesht? E tash, jashtë...

- Kadalë... ia priti djaloshi me t'egër e sytë i vetuen: - dal vetë, s'ashtë nevoja me më qitë jashtë ti. Por edhe një fjalë due me t'a thanë e të lutem vire ne vesh si at këshillë qi më dhae par në dugajë. Ti thue se jeton, por rrehesh. Ti je shlye prej numrit të të gjallëve qyshse je ndry në kët dugajë mbushë me mall. Ky asht vorri i yt. E sa për Shqipni po të siguroj un se ka me qindrue. Prandej mos ban merak se edhe flamujt kanë me t'u shitë krejt. Por rueje shpirtin t'and mos t'ia shtish dreqit.

E Hilush Vilza doli, lehtësue në zemër nga ai shfrim, me thithë ajr të kulluet n'udhë sepse era e asaj dugaje i mirrte frymën.

Për pyetjet nga 1 deri në 7 rrethoni alternativën e saktë.

1. “Tregtarë flamujsh” është: **1 pikë**
- A) roman;
  - B) tregim;
  - C) skicë;
  - D) dramë.
2. Personazhet janë në kundërvënie me njëri-tjetrin, sepse i ndan: **1 pikë**
- A) besimi fetar;
  - B) brezat;
  - C) mjedisi;
  - D) mentaliteti.
3. Në këtë vepër të Koliqit paraqitet jeta: **1 pikë**
- A) malësore;
  - B) qytetare shkodrane;
  - C) e fshatrave të Shkodrës;
  - D) e kryeqytetit shqiptar;
4. Gaspër Tragaçi mendon se të jesh i lirë duhet: **1 pikë**
- A) të jesh i pasur;
  - B) të jesh poet;
  - C) të jesh intelektual;
  - D) të jesh antikonformist.
5. “Tregtarë flamujsh” ndërtohet mbi figurën e: **1 pikë**
- A) alegorisë;
  - B) simbolit;
  - C) kontrastit;
  - D) paralelizmit figurativ.
6. Toni me të cilën Gaspër Tragaçi thotë: “Jeto me prralla, bieru mbas andrrave” është: **1 pikë**
- A) agresiv;
  - B) përçmues;
  - C) indiferent;
  - D) vlerësues.
7. Në fjalinë: “Mija agimesh epopeje të kuqe fjetë në burgun e një kohe të mugët”, fjala të mugët ka kuptimin: **1 pikë**
- A) të mjegullt;
  - B) të qetë;
  - C) të ftohtë;
  - D) të ndritur.

8. Ç'përfaqëson flamuri si simbol? Si e kuptoni simbolikën e re që fiton titulli?

2 pikë

---



---

9.

a) Ku ndryshojnë nga njëri-tjetri të dy personazhet? Gjeni një moment në fragment ku shfaqet ky ndryshim.

3 pikë

---



---



---

b) A mund të pajtohen dy qëndrimet që përfaqësojnë personazhet në vepër? Shpjegoni pse.

2 pikë

---



---

10. Lexoni me kujdes paragrafin e dytë të këtij fragmenti. Zbuloni dy veçori të tij, që i japin asaj tiparet e një **proze poetike**.

2 pikë

---



---

11. Gjeni në tekst dy fjalë dialektore, një emër dhe një folje. Shkruani trajtën e tyre përkatëse në gjuhën standarde.

2 pikë

emër: \_\_\_\_\_

folje: \_\_\_\_\_

12. Çfarë kërkon të na dëshmojë Koliqi në lidhje me atdhetarinë?

1 pikë

---



---

13. Në personazhin e Hilush Vilzës shfaqen elemente autobiografike të shkrimtarit. Identifikoni dy tipare të ngjashme mes tyre.

2 pikë

---



---

**Pjesa II****Zhan Rasin****Andromaka (fragment)****Akti III - Skena VIII****Sefiza**

Megjithëse Greqia kërkon t'jua shpaguajë  
Ju prapë mund të ishit zonj' e fatit tuaj

**Andromaka**

Si jua thotë goja këto, oh, me ç'qëllim?  
Kështu, s'më mbetej veçse t'ndëshkoja djalin tim.

**Sefiza**

Dhe aq besnike burrit! Po mjaft, zonja ime,  
Virtyt i tepruar ju shpie dhe në krime.  
Pastaj dh'ai do thoshte: "Po jo me aq furi".

**Andromaka**

Ç'thua! Mendon që Pirrua të zër' vendin e tij?

**Sefiza**

E do e mir' e djalit, se grekët jua kërkojnë.  
Mos druani se shpirtrat lëndohen, ju mallkojnë?  
Si vallë ta përbuzni një mbret' e ngadhënjimtar  
Që do t'ju bëj të ngrihi në fronin trashëgimtar  
Që shqelm u jep për juve armiqve fryrë nga inati,  
Që as kujtohet fare se Akili ish i Ati  
Dhe s'përmend fitoret, se druhet se mos krenohet.

**Andromaka**

Duhet t'harroj dhe unë, sepse ai s'kujtohet?  
Si ta harroj Hektorin q'e lanë pa varrosur,  
Për turp ma hiqnin zvarrë rreth mureve, xhindosur?  
Si ta harroj të atin që ra përpara meje,  
Në gjak duke spërkatur të shenjtën vatër feje?  
Kujto, kujto, Sefizë, oh, atë natë ferri.  
Kujtoje mirë Pirron, synxirë n'ata parmakë,  
Kur erdh n'pallatet tona mes hijesh zjarr e flakë,  
M'i shkelte ata vëllezër të hapte një rruginë,  
Në gjak i tërë përlyer vraste, bënte kërdrinë.  
Kujto ata q'u mburrnin dh'ata q'u rrokullisnin  
Kujtoje Andromakën tmerruar mes llahtari;  
Përfytyroj dhe Pirron sesi e pashë së pari  
Ja se nga çfarë veprash arriti u lartësua,  
Së fundi, ja çfarë burri kërkon të gjesh për mua!  
Jo, kurr' e kurrë s'bëhem shoqe me një gjakësor,  
Po desh le t'na ndëshkojë therorë.  
Sikur ta meritja, urrejtja do s'ishte e vështirë.

**Sefiza**

Aher' eja të shohim si do mbarojë yt bir.  
Po presim fjalën tuaj...ju dridhi zonja ime!

**Andromaka**

Medet! Ç'ma shpove zemrën aq thellë m'ato kujtime!

Po ç'farë, Sefizë, prapë në dorën e mizorit,  
Tim bir, gëzimin e jetës, fytyrën e Hektorit!  
Dritën e syve t'tij që peng ma dorëzoi!  
O vaj, si më kujtohet! Se atë ditë që shkoi  
Të matej me Akilin e vdekjen ta kërkonte,  
Kërkoi dhe të birin ndër krahë ta shtrëngonte.  
Duke m'i fshirë lotët, më tha:"E dashur grua,  
S'e di a do të kthehem, ç'fat është thënë për mua  
Në shenjë besnikërie të lë këtë fëmi,  
Në mos iu ktheft' i ati, baba t'm'i bëhesh ti.  
Nëse martesën tonë përjet' e ke kujtim,  
E gjer në ç'pikë më deshe, tregoja djalit tim".  
Si mund ta shoh t'humbasë një gjak aq shumë i çmuar,  
E bashkë me të të shuhet një fis i lavdëruar!  
O mbret barbar për mua të zhdukësh një fëmi?  
Nëse unë të urrej, ç'faj paska vallë ai?  
Mos vallë duhet ta qortoj e t'i përmend  
Vrasjet mizoritë ai që s'di gjësend?  
Hanhari i gjakatarit është gati të të qëllojë,  
Nëse jot ëmë s'do mundtë, o bir, që ta ndalojë!  
S'e di përse po shtangem, kur prapë e kam në dorë!  
Po jo, s'të lë të vdesësh, s'të lë kjo nën e gjorë.  
Hajt ta takojmë Pirron. Oh, moj Sefiz' e shtrenjtë,  
Shko ti më mir' i thuaj.

**Sefiza**

Ç't'i them, o qiell i shtrenjtë?

**Andromaka**

Thuaj' se dashuria që kam për djalin tim...  
Po prit, vërtetë tha se paska marrë vendim?  
Vërtet ndjenja e zjarrtë e shtyn të gjakësohet?

**Sefiza**

E kush' i flet atij moj zonjë, do tërbohohet!

**Andromaka**

Eh, mirë, shko, premtoji

**Sefiza**

Për besë e vërtetë!

**Andromaka**

Bobo! Po çfarë bese, kur nuk besoj as vetë  
O eshtrat e tim shoqi! O Trojë, o ti o atë!  
Sa shtrenjtë' po të paguan o bir, kjo nën e ngratë!

**Sefiza**

Po ku. Mojt zonjë? A more një vendim?

**Andromaka**

Të shkojmë atje te varri, të pyesim burrin tim.

*Për pyetjet nga 14 deri në 19 rrethoni alternativën e saktë.*

**14.** Kjo tragjedi është mbështetur në:

**1 pikë**

- A) shkrimet e shenjta;
- B) mitologjinë greke;
- C) kronikat e lashta angleze;
- D) gojëdhënat e vjetra franceze.

**15.** Nga fragmenti vëmë re se pika më e dobët e Andromakës është:

**1 pikë**

- A) djali i saj i vetëm.
- B) kujtimi i vëllezërve.
- C) kujtimi i Trojës së djegur.
- D) pamundësia për të varrosur të shoqin.

**16.** Në cilën nga alternativat e mëposhtme është përdorur figura e pasthirmës?

**1 pikë**

- A) Ç't'i them, o qiell i shtrenjtë?
- B) Mendon që Pirrua të zër' vendin e tij?
- C) Tim bir, gëzimin e jetës, fytyrën e Hektorit!
- D) Sa shtrenjtë' po të paguan o bir, kjo nën e ngratë!

**17.** Në cilën nga alternativat e mëposhtme është përdorur toni urdhërues?

**1 pikë**

- A) Si ta harroj të atin që ra përpara meje.
- B) Po presim fjalën tuaj...ju dridhi zonja ime!
- C) Shko ti më mir' i thuaj.
- D) Së fundi, ja çfarë burri kërkon të gjesh për mua!

**18.** Toni me të cilën Andromaka i drejtohet në fund Sefizës është:

**1 pikë**

- A) i dëshpëruar;
- B) i qetë;
- C) indiferent;
- D) i nervozuar.

**19.** Cila nga fjalët e mëposhtme është e përbërë?

**1 pikë**

- A) barbar;
- B) gjakatar;
- C) trashëgimtar;
- D) synxirë.

20.

- a) Andromaka shfaqet në këtë fragment në një gjendje të vështirë shpirtërore. Çfarë e ka shkaktuar atë? Ilustrojeni mendimin tuaj me detaje ose vargje nga fragmenti. **2 pikë**

---



---

- b) Cila është një nga arsyet themelore që ajo nuk pranon të martohet me Pirron? **1 pikë**

---

21.

- a) Pse Andromaka e risjell edhe një herë (vargjet 20-30) atmosferën e Luftës së Trojës? **1 pikë**

---



---

- b) Cilat janë disa nga fjalët kyç që ajo përdor dhe ç'tablo krijojnë ato? **3 pikë**

---



---

22. Figura e Pirros shfaqet ndryshe në portretizimin që i bën Andromaka dhe në atë që i bën Sefiza. Cili është thelbi i këtij portreti për secilën nga personazhet? **2 pikë**

**Andromaka****Sefiza**


---



---

23.

- a) Në këtë fragment ka një përdorim të kohës së shkuar dhe të tashme. Gjeni nga një ilustrim për secilën kohë. **2 pikë**

**Koha e tashme:** \_\_\_\_\_**Koha e shkuar:** \_\_\_\_\_

- b) Cila është arsyeja që mbizotëron koha e shkuar? **1 pikë**

---

24. Interpretoni përmes dy figurave të stilistikës vargjet e mëposhtme. **3 pikë**

*Bobo! Po çfarë bese, kur nuk besoj as vetë  
O eshtrat e tim shoqi! O Trojë, o ti o atë!  
Sa shtrenjtë' po të paguan o bir, kjo nën e ngratë!*

---



---



---

